

Platforma CiviKos është duke kërkuar një Zyrtar/e të Financave

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar

- Së paku diplomë Bachelor në Ekonomi, Financa apo fusha të ngjashme;
- Përvojë në menaxhim financiar së paku tri vite (e preferueshme përvoja në sektorin jo-qeveritar);
- Aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e QuickBooks dhe Excel;
- Njohuri dhe përvojë me kornizën ligjore të Kosovës, praktikat më të mira të kontabilitetit dhe procedurat e prokurimit;
- Njohuri për legjislacionin tatimor në Kosovë;
- Përvojë dhe njohuri në menaxhim financiar për projekte të financuara nga USAID, BE, dhe donatorë ndërkombëtarë;
- Përvojë në planifikim financiar;
- Aftësi të mira komunikimi dhe në të shkruar në shqip dhe anglisht;
- Aftësi të mira ndër-personale dhe shkathtësi të bashkëpunoj mirë me organizata dhe donatorë.

Përgjegjësitë kryesore janë:

- Ekzekutimi i pagesave, pagave dhe tatimeve në përputhje me procedurat e brendshme dhe legjislacionin tatimor në Kosovë;
- Përgjegjës për planifikim financiar dhe hartim të buxheteve për donator të ndryshëm;
- Përgatitja e raporteve financiare për projekte të ndryshme në përputhje me kërkesat e donatorëve;
- Të mirëmbajë të gjitha të dhënat financiare të projektit dhe organizatës në tërësi;
- Të organizoj procedurat e prokurimit të projekteve;
- Të ndërmarrë planifikime për financa dhe raportim në bashkëpunim të ngushtë me menaxherët e projekteve;
- Të sigurojë dorëzimin në kohë të raporteve përkatëse.

Dokumentet për dorëzim

- Një CV të kandidatit/es;
- Një letër motivuese (max. 1 faqe A4) për përvojën dhe motivin për t'iu bashkuar ekipit të CiviKos.

Dokumentet e kërkuara mund t'i dërgoni deri më **22.09.2021** në email info@civikos.net me titullin të e-mailit (subject) "Aplikimi për zyrtar/e të financave".

Petëm kandidatët e listës së ngushtë do të kontaktohen për fazën tjetër të rekrutimit.

Platforma CiviKos (www.civikos.net) është bashkim vullnetar i organizatave të shoqërisë civile, të përkushtuara për zhvillimin e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunim midis shoqërisë civile dhe autoriteteve publike.